

1 E mërkurë 26 prill 2017

2 Hagë, Hollandë

3 Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtetuese

4 [Vendimi]

5 [Seancë e hapur]

6 --- Gjatë fillimit në 12.07

7 NDIHMES GJYQI: Të gjithë në këmbë. Ju lutemi të uleni.

8 GJYKATËSI POWER-FORDE: Lus sekretarin e gjykatës që të parashtrojë
9 çështjen.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: Në çështjen e referimit të Rregullores të
11 Procedurës dhe Provave, numër KSC-CC-PR-2017-01.

12 GJYKATËSI POWER-FORDE: Good afternoon. Mirëdita. Dobar dan.

13 E shpall të hapur seancën e nxjerrjes së vendimit të Dhomës së
14 Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në çështjen e referimit të
15 Rregullores së Procedurës dhe Provave, në përputhje me nenin
16 19(2) të Ligjit nr. 05/L-053, për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën
17 e Prokurorit të Specializuar, më tej në tekst "Ligji."

18 Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Gjykatësit e Seancës Plenare dhe
19 publiku përgjithësisht janë informuar në kohë për datën dhe kohën e
20 kësaj seance.

21 Seancën Plenare, e cila e nxori këtë referim, e kryesoi Kryetarja
22 e Dhomave të Specializuara të Kosovës, të cilës në emër të panelit të Gjykatës
23 i uroj mirëseardhje.

24 Procedura.

25 Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, e cila e rregullon funksionimin

1 e Dhomave të Specializuara të Kosovës, u meritua prej gjykatësve të
2 të Dhomës, Dhomave të Specializuara të mbledhur në Seancën Plenare, më tej
3 ("Plenarja") më datën 17 mars 2017.

4 Rregullat.

5 Më 27 mars 2017, Rregullorja iu referua Dhomës së Specializuar të
6 Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 19 (5) të Ligjit.

7 Duke u bazuar në Nenin 33(3) të Ligjit, për shqyrtimin e rregullores,
8 u caktua një panel prej tre gjykatësish të Dhomës së Specializuar
9 të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu u caktua edhe një gjykatës rezervë.

10 Të dhënat procedurale.

11 Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese u formua në kuadër
12 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Kosovës dhe nëpërmjet
13 shqyrtimit të kushtetutshmërisë së Rregullores të Procedurës dhe të
14 Provave, ushtron kompetenca mbikqyrëse mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën
15 e Prokurorit të Specializuar dhe rrjedhimisht shërben si garantues shtesë i
16 Kushtetutës.

17 Referimi iu dorëzua Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese
18 me 27 mars 2017, dhe nga ajo datë, Gjykata kishte 30 ditë për shqyrtimin e
19 Rregullores për të garantuar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II të
20 Kushtetutës.

21 Më 29 dhe 30 mars, dhe më 10, 11, 22 dhe 23 prill të 2017, Dhoma e
22 Specializuar e Gjykatës Kushtetuese zhvilloi kuvendime në privatësi, në lidhje
23 me rregulloren ashtu siç e kishin miratuar gjykatësit në Seancën Plenare.

24 Tani do t'u paraqes një përmbledhje të shkurtër të vendimit që Gjykata
25 miratoi sot, më 26 prill, dhe më pas do të lexoj dispozitat vendimore të tij.

1 Kjo përmbledhje nuk është pjesë e aktvendimit dhe nuk është detyruese për
2 Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Një kopje e kësaj përmbledhjeje
3 dhe arsyetimi do të vihet në dispozicion në fund të kësaj seance në një
4 komunikatë për shtyp. Teksti i plotë i aktvendimit do të vihet në dispozicion
5 dhe mund të lexohet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

6 Çështja

7 Çështja që iu referua Dhomës të Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ngre
8 pyetjen nëse Rregullorja e Procedurës dhe e Provave ashtu siç e miratuan nga
9 Plenarja, është në përputhje me Kapitullin II, përfshirë Nenin 55 të
10 Kushtetutës të Kosovës. Kapitulli II i Kushtetutës trajton të drejtat dhe
11 liritë themelore.

12 Fillimisht Gjykata konstatoi se referimi ishte i pranueshëm sepse ishte
13 bërë në përputhje me Ligjin. Për shqyrtimin e Rregullores, Gjykata u bazua në
14 Nenin 19 (2), i cili kërkon që Rregullorja të pasqyrojë standardet më të larta
15 të drejtave të njeriut, me synimin e garantimit të një gjykimi të drejtë dhe
16 të shpejtë.

17 Gjykata e interpretoi çdo rregull mbi bazën e gjuhës konkrete të tekstit,
18 ashtu siç ishte miratuar nga Plenarja. Për aq sa ishte e mundshme, gjatë
19 shqyrtimit të rregullores, Gjykata zbatoi doktrinën e interpretimit harmonik.
20 Kudo ku kuptimi i drejtëpërdrejtë i tekstit e lejonte një gjë të tillë.
21 Gjykata procedoi mbi bazën e arsyetimit se dispozita e një rregulle të veçantë
22 nuk duhet interpretuar e shkëputur nga pjesët e tjera të rregullores por duhet
23 të interpretohet në harmoni me to. Në rast se një rregull trajton një çështje
24 të drejtave themelore të njeriut të garantuara me kushtetutë, rregulla
25 shqyrtohej në imtësi dhe tërësi, me qëllim që të përcaktohej përputhshmëria

1 e saj e përgjithshme me Kapitullin II të Kushtetutës. Në interpretimin
2 e dispozitave të Kushtetutës për të drejtat e njeriut, Gjykata ka mbajtur
3 parasysh Nenin 53, i cili parashtron se dispozita të tilla duhet interpretuar
4 në një mënyrë që është në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës
5 Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6 Konstatimet.

7 Pasi shqyrtoi 208 rregullat e miratuara nga Plenarja, Gjykata
8 konstatoi se nëntë rregulla ishin në mospërputhje me Kapitullin II të
9 Kushtetës. Gjykata nuk arriti të nxjerrte konstatim në lidhje me një rregull
10 tjetër, si rrjedhojë, për 198 rregulla u konstatua se nuk ishin në
11 mospërputhje me Kushtetutën.

12 Rregullat për të cilat Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
13 konstatoi se ishin në mospërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
14 ishin si vijon:

15 Rregulla 19 (3).

16 Për aq sa kjo Rregull lejonte që seancat të vijonin të zhvilloheshin në
17 prani të dy anëtarëve të një paneli, në mungesë të anëtarit të tretë të tij,
18 Gjykata arriti në përfundimin se një seancë e tillë nuk ishte seancë përpara
19 një gjykate të themeluar me ligj siç e kërkon Neni 31 (2) i Kushtetutës.
20 Arsyet e këtij konstatimi parashtrihen në aktvendim por në thelb përqëndrohen
21 në çfarë kërkon ligji lidhur me përbërjen e paneleve të Dhomave të
22 Specializuara të Kosovës.

23 Rregulla 31, 32 dhe 33

24 Rregulla 31, 32 dhe 33 u konstatuan nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës
25 Kushtetuese se janë në mospërputhje me të drejtën themelore të privatësisë

1 sipas nenin 36 t'Kushtetutës sikurse cilësohet nga Neni 55 i saj. Këto
2 rregulla parashikojnë autorizimin e masave hetimore të posaçme
3 përfshirë përgjimin e komunikimeve private. Sipas mendimit të Gjykatës,
4 ato nuk përmbanin garanci të kërkuara minimale mbrojtëse që janë të
5 domosdoshme sipas standardeve më të larta për të drejtat e njeriut.
6 Rregullat nuk përcaktonin kategori të personave për të cilët mund të
7 zbatoheshin masat. Atyre u mungonte saktësia e mjaftueshme lidhur me
8 kohëzgjatjen e përgjimit të komunikimeve dhe përmbanin garanci të
9 pamjaftueshme lidhur me mbajtjen e asgjësimit e t'dhënave t'marra si
10 rrjedhojë e ktyre masave. Gjykata konstatoi se kto rregulla, me
11 formën që ishin miratuar nuk përmbushnin kërkesën e cilësisë së ligjit,
12 sipas Nenit 55 të Kushtetutës dhe nuk mund të demonstronin se ndërhyrja
13 e lejuar ishte brenda konceptit domosdoshme në një shoqëri demokratike.

14 Rregulla 35 (1) dhe Rregulla 35 (3)

15 Rregulla 35 parashtron procedurën e kontrollimit dhe sekuestrimit
16 që kryhet nga Prokurori i Specializuar, në mungesë të autorizimit
17 paraprak nga Gjykata. Gjykata konfirmoi se kërkohet një kornizë e qartë
18 ligjore dhe vendosja e kufijve të rreptë mbi kto kompetenca për mbrojtjen
19 e personave nga ndërhyrja arbitrare prej autoriteteve me të drejtën e
20 respektimit të privatësisë të mbrojtur nga Kushtetuta.

21 Gjykata konstatoi se kompetencat e dhëna Prokurorit të Specializuar
22 prej Rregullës 35 (1) (b) dhe 35 (1) (c) ishin tejet të zgjeruara dhe nuk
23 përmbushnin kërkesat e domosdoshmërisë të parashikuara në Nenin 36 (2) të
24 Kushtetutës. Gjykata gjithashtu konstatoi se rishikimi gjyqësor ex post
25 facto i përcaktuar n'Rregullën 35 (3) nuk parashikonte përfshirjen e një

1 vlerësimi mbi proporca, proporcionalitetin e masës dhe si rrjedhojë
2 nuk e kufizonte efektin e kontrollimeve dhe sekuestrimeve brenda
3 konceptit e domosdoshme në një shoqërie demokratike.

4 Rregulla 36 (1) dhe Rregulla 36 (2)

5 Rregulla 36 ka t'bëjë me ekzekutimin e operacioneve të kontrollit dhe
6 sekuestrimit. Gjykata konstatoi se Rregulla 36 (1) dhe Rregulla 36 (2) nuk
7 ishin formuluar me shkallën e kërkuar të saktësisë për sa i përket
8 zbatueshmërisë dhe përdorimit të tyre. Për këtë arsye ato nuk plotësonin
9 kërkesën e cilsisë t'ligjit që është pjesë e pandarë e termit "me ligj" siç
10 parashikohet me Nenin 55 (1) të Kushtetutës.

11 Rregulla 38(1) dhe Rregulla 38(5).

12 Rregulla 38 përcakton ekzaminimin mjeko-ligjor për mbledhjen e
13 monstrave trupore si qimet, pështymën, monstat e gjakut, ADN-së dhe
14 materialeve të tjera të ngjashme. Rrjedhimisht kjo rregull trajton
15 të drejtat e paprekshmërisë fizike dhe të privatësisë sipas Nenit 26
16 të Kushtetutës.

17 Rregulla 38 (1) përcakton kompetencën e Prokurorit të Specializuar
18 për të urdhëruar mbledhjen dhe ekzaminimin prej ekspertve të monstrave
19 të qimeve, pështymës dhe monstrave të tjera, të cilat mund të merren pa
20 ndërhyrje trupore.

21 Gjykata konsideroi se në lidhje me lejen e parashikuar në këtë dispozitë
22 për marrjen e monstrave të qimeve, pështymës ose mostrave të tjera nga një
23 person në dallim nga një objekt me të cilin personi ka qenë në kontakt,
24 marrja e tyre nuk mund të bëhet pa ndërhyrje trupore sado e vogël qoftë kjo
25 ndërhyrje. Në mungesë të garancive të mjaftueshme për rrethanat kur një person

1 nuk ka dhënë pëlqimin për marrjen e monstrave të qimeve, të
2 pështymës ose monstrave tjera, Gjykata konstatoi se Rregulla 38 (1) ishte në
3 mospërputhje me kërkesën e domosdoshmërisë sipas nenës, ëëë, sipas Nenit 55 (2)
4 të Kushtetutës.

5 Gjykata gjithashtu konstatoi se Rregulla 38 (5) ishte në mospërputhje
6 me Kushtetutën, sepse parashikonte mbajtjen për një kohë të konsiderueshme
7 të konsiderueshme të të gjitha materialeve, përfshirë edhe mostrat qelizore
8 t'mbledhura nga një person, pa bërë ndonjë vlerësim t'veçantë të
9 domosdoshmërisë të tyre sipas rrethanave konkrete në secilin rast. Gjykata
10 konstatoi se mbajtja e monstrave të tilla trupore nuk vendoste një baraspeshë
11 të drejtë ndërmjet interesave konkurruese publike dhe private përkatëse, në
12 shkelje të Nenit 55 (4) të Kushtetutës.

13 Rregulla 54

14 Rregulla 54 përmban dispozita për rishikimin dhe rishqyrtimin e mbajtjes
15 në paraburgim. Gjykata konstatoi se rregulla 54 (4) kërkonte një shqyrtim të
16 imët dhe qartsim të mëtejshëm. në një lexim të drejtëpërdrejtë, dispozita e
17 bën lirimin e një personi të paraburgosur krejtësisht të varur nga pëlqimi i
18 një shteti të tretë edhe në rrethanat kur një panel ka vendosur se ekzistojnë
19 arsye të mjaftueshme që të kërkojnë lirimin e të paraburgosurit. Gjykata
20 konstatoi se në pamje të parë kjo dispozitë specifike e Rregullës 54 (4) ishin
21 në mospërputhje me Nenin 28 të Kushtetutës.

22 Rregulla 158 (2)

23 Rregulla 158 (2) trajton mbajtjen në paraburgim të një personi që është
24 shpallur i pafajshëm pas gjykitimit. Gjykata konstatoi se mbajtja e mëtejshme
25 në paraburgim e një personi të pafajshëm nuk parashikohet me ligj dhe nuk

1 përfshihet në një prej arsyeve t'lejshme për privimin e lirisë.

2 Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kjo dispozitë ishte
3 në mospërputhje me Nenin 29 të Kushtetutës.

4 Rregulla 134 (3).

5

6 Për arsyet e paraqitura në aktvendimin e saj, Gjykata nuk mundi të
7 nxirrte konstatim nëse rregulla 134 (3) ishte në përputhje me Kapitullin II
8 të Kushtetutës.

9 Ky vendim hyn në fuqi menjherë sot.

10 Dispozitat vendimore.

11 Pasi kam dhënë një përmbledhje të shkurtër të shqyrtimit të Gjykatës
12 tani do t'i lexoj dispozitat vendimore të aktvendimit me anë të të cilave
13 Gjykata:

14 (1) Shpall njëzëri se referimi është i pranueshëm

15 (2) Vleron njëzëri se Rregullat 31, 32, 33 dhe 35 (1) (b) dhe (c) dhe
16 36 (1) dhe (2) dhe Rregulla 38 (1) dhe (5) dhe Rregulla 54 (4) janë në
17 mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

18 (3) Vleron me shumicë se Rregullat 19 (3) dhe 158 (2) janë në
19 mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

20 (4) Vleron njëzëri se nuk është në gjendje të shpallë se Rregulla
21 134 (3) është në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës, dhe

22 (5) Vleron njëzëri se dispozitat e tjera të rregullores nuk janë në
23 mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

24 Këtu përfundon seanca e pasdites dhe rrjedhimisht e deklaroj të mbyllur.

25 Të gjithë në këmbë.

1 --- Dëgjimi përfundoi më 12.23

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25